



**Deklaratë për shtyp- 250/03/2021**

**Aktualizimi dhe zgjerimi i Urdhëresës për  
Mbrojtjen nga Koronavirusi - Nordrhein-  
Westfalen bashkon Rregulloren e Frenës së  
Emergjencës me strategjinë e forcuar të  
testimit**

26.03.2021  
Faqja 1 nga 6

Pressestelle Staatskanzlei  
40213 Düsseldorf  
[presse@stk.nrw.de](mailto:presse@stk.nrw.de)

Telefon 0211 837-1134  
0211 837-1405  
0211 837-1151

Numri i telefonit të  
qytetarëve 0211 837-1001  
[nrwdirekt@nrw.de](mailto:nrwdirekt@nrw.de)

[www.land.nrw](http://www.land.nrw)

**Ministri Laumann: Ne mund ta luftojmë virusin më mirë dhe me më  
shumë saktësi, veçanërisht në rastet e infeksioneve të shpërndara  
Qeveria e Landit ju informon si më tej:**

Nordrhein-Westfalen po implementon në mënyrë rigoroz vendimet e marra gjatë konsultimeve midis qeverisë federale dhe qeverive të Landeve dhe po përshtat Urdhëresën për Mbrojtjen nga Koronavirusi në përputhje me to. Për shkak të vlerës prej 121,6 të incidencës 7-ditore në të gjithë Landin (bazuar tek të dhënat e datës 26 mars 2021), hyn gjithashtu si më tej në fuqi në Nordrhein-Westfalen rregullorja e frenës emergjente për të cilën është rënë dakord në nivel federal : në të gjitha qarqet dhe qytetet pa qarqe tek të cilat vlera e incidencës do të jetë mbi 100, do të anulohen masat e lehtësuara të cilat kanë hyrë në fuqi me datë 8 mars.

Gjithsesi, duke pasur parasysh prezencën e më shumë se 4800 qendrave të testimit në Land dhe strukturën e mirëzhvilluar të shpërndarjes së testeve të shpejta falas për qytetarët në Nordrhein-Westfalen, komunat e afektuara do të kenë mundësinë t'i zhvillojnë shërbimet e tyre rreptësisht në prezencën e një testi negativ ditor në vend të anulimit total të lehtësimit të masave.

Urdhëresa hyn në fuqi në datën 29 mars 2021 dhe është efektive përkohësisht deri në 18 prill 2021.

Duke patur parasysh rritjen e numrit të rasteve me infeksion, Frena e Emergjencës së Koronavirusit është e bazuar fuqishëm tek Urdhëresa me rregullore të qarta. Diferencimi rajonal merr në konsideratë nivelet gjithnjë e më të ndryshme të infektimit në qytete dhe qarqe:

Frena e Emergjencës së Koronavirusit hyn në fuqi nëse vlera 7 ditore e incidencës në një qytet ose qytet pa qark i kalon 100 infeksione të reja për 100,000 banorë për 3 ditë pune rresht. Pastaj komuna e afektuar, në bashkëpunim të ngushtë me

Ministrinë e Shëndetësisë, vendos midis 2 opsioneve: lockdown i rreptë shoqëruar me anulim të masave të lehtësuara të cilat hynë në fuqi në 8 mars 2021 ose opsioni i testimit. Me zgjedhjen e opsionit të testimit, këto masa të lehtësuara mund të vazhdojnë të jenë të vlefshme, por vetëm për klientët, vizitorët, përdoruesit me rezultat testimit ditë negativ.

Ministri i Shëndetësisë Karl-Josef Laumann: “Me versionin e ri të Urdhëresës, Nordrhein-Westfalen po shtyp frenat e emergjencës për Koronavirusin dhe në të njëjtën kohë po sjell perspektiva të reja. Versioni i Nordrhein-Westfalen ka 2 avantazhe madhore: Qarqet e afektuara dhe qytetet pa qarqe mund të shtypin frenat e emergjencës dhe të vendosin sërish kufizime tek jeta publike. Nga ana tjetër, opsioni i testimit vlen si rrjetë sigurie për infeksionet e koronavirusit. Ky opsion nxit popullsinë të testohet dhe personat pa simptoma ose të padiagnostikuar mund të diagnostikohen dhe të filtrohen. Kjo ndodh sepse çdo test pozitiv i shpejtë përmban një test PCR, çka do të thotë se mund ta luftojmë virusin më me efikasitet dhe ta shenjestrojmë më me saktësi, veçanërisht kur numrat e rasteve me infeksion janë kaq të ndryshueshëm.”

Këto rregulla vlejné gjithashtu gjatë pushimeve të Pashkëve. “Gjithsecili është sërish i lutur të qëndrojë në shtëpi gjatë pushimeve të Pashkëve, të mos udhëtojë dhe t’u përmbahet rregullave të AHA (Të mbajë distancën, të respektojë rregullat e higjienës dhe të mbajë një maskë të thjeshtë)”, u shpreh Ministri Laumann. “Çdo person është përgjegjës për luftimin e virusit. Për më tepër, qeveria federale ka njoftuar shpërndarjen e sasive të mëdha të vaksinave. Kjo më jep shumë shpresë sepse ne do të mund të hedhim një hap madhor drejt vaksinimeve.”

**Një përmbledhje e ndryshimeve më të rëndësishme të Urdhëresës për Mbrojtjen nga Koronavirusi, më datë 29 mars 2021:**

	<b>Incidenca 7 ditore &lt;100</b>	<b>Incidenca 7 ditore &gt;100 pa opsionin e testimit</b>	<b>Incidenca 7 ditore &gt;100 me opsionin e testimit</b>
<b>Kufizimet e kontakteve</b>	Takimet në hapësira publike janë të mundshme me maksimumi 5 persona nga dy bashkësi familjare.	Takimet në hapësira publike janë të mundshme me maksimumi një person nga një bashkësi tjetër familjare. Fëmijët deri në moshën 14 vjeç (duke e përfshirë këtë moshë)	Takimet në hapësira publike janë të mundshme me maksimumi një person nga një bashkësi tjetër familjare. Fëmijët deri në moshën 14 vjeç (duke e përfshirë këtë moshë)

<p>Fëmijët deri në moshën 14 vjeç (duke e përfshirë këtë moshë)</p> <p>përrjashtohen nga ky numërim.</p> <p>Pavarësisht kushteve të banimit, çiftet konsiderohen një bashkësi familjare. Përrjashtim gjatë pushimeve të pashkëve (1-5 Prill): këtu vlejné po ato rregullore si në rastin e incidencës prej 50-100, pra lejohen të takohen 2 bashkësi familjare me maksimumi 5 persona, duke përrjashtuar fëmijët deri në moshën 14 vjeç (duke e përrshirë këtë moshë).</p>	<p>përrjashtohen nga ky numërim. Pavarësisht kushteve të banimit, çiftet konsiderohen një bashkësi familjare. Përrjashtim gjatë pushimeve të pashkëve (1-5 Prill): këtu vlejné po ato rregullore si në rastin e incidencës prej 50-100, pra lejohen të takohen 2 bashkësi familjare me maksimumi 5 persona, duke përrjashtuar fëmijët deri në moshën 14 vjeç (duke e përrshirë këtë moshë).</p>	<p>përrjashtohen nga ky numërim. Pavarësisht kushteve të banimit, çiftet konsiderohen një bashkësi familjare. Përrjashtim gjatë pushimeve të pashkëve (1-5 Prill): këtu vlejné po ato rregullore si në rastin e incidencës prej 50-100, pra lejohen të takohen 2 bashkësi familjare me maksimumi 5 persona, duke përrjashtuar fëmijët deri në moshën 14 vjeç (duke e përrshirë këtë moshë).</p>
--	---	---

**Bibliotekat, arkivat, etc**

Lejohet të zhvillojnë veprimtaritë e tyre vetëm duke respektuar rreptësisht rregullat e higjienës dhe të ruajtjes së distancës.

Veprimtaritë janë të kufizuara në marrjen dhe dërgimin e objekteve fizike të medias, të cilat mund të porositen ose të merren nga vetë personi, si dhe në rikthimin e tyre.

Lejohet veprimtaria vetëm duke respektuar rreptësisht rregullat e higjienës dhe të ruajtjes së distancës. **Hyrja është e mundur vetëm duke paraqitur një rezultat negativ të testimit të shpejtë** . Ky test nuk duhet të jetë më i vjetër se 24 orë.

**Muzetë, Ekspozitat, Kështjellat, Kalatë, Përmendoret, etj.**

Veprimtaria e muzeve, ekspozitave të artit, galerive, kështjellave, kalave, përmendoreve dhe institucioneve të ngjashme, lejohet vetëm duke rezervuar takim më përpara dhe duke siguruar gjurmueshmërinë. Në mjedisë të mbyllura, numri i vizitorëve të pranishëm në të njëjtën kohë nuk duhet ta kalojë atë të një personi për 20 metër katror.

Veprimtaria e tyre ndalohet.

Veprimtaria e muzeve, ekspozitave të artit, galerive, kështjellave, kalave, përmendoreve dhe institucioneve të ngjashme, lejohet vetëm duke rezervuar takim më përpara dhe duke siguruar gjurmueshmërinë. Në mjedisë të mbyllura, numri i vizitorëve të pranishëm në të njëjtën kohë nuk duhet ta kalojë atë të një personi për 20 metër katror. **Hyrja është e mundur vetëm duke paraqitur një rezultat negativ të testimit të shpejtë** . Ky test nuk duhet të jetë më i vjetër se 24 orë.

<p><b>Kopshtet</b></p> <p><b>zoologjike, parqet e kafshëve</b></p> <p><b>Parqet e natyrës me rregullore hyrje</b></p>	<p>Lejohen sërish me rezervim takimi të bërë më përpara dhe me gjurmueshmëri të siguruar, vizitat tek kopshtet zoologjike dhe parqet e kafshëve. Gjithashtu në hapësira të mbyllura numri i vizitorëve të pranishëm në të njëjtën kohe nuk duhet të kalojë 1 person për 20 metër katror. Në mjedise të jashtme nuk ka specifikime për numrin e lejuar të personave për 20 metër katror.</p>	<p>Ndalohet për vizitorët hyrja tek mjediset e mbyllura ku zhvillohen ekspozita.</p>	<p>Lejohen sërish vizitat tek kopshtet zoologjike dhe parqet e kafshëve, me detyrimin e rezervimit të takimit të bërë më përpara dhe me gjurmueshmëri të siguruar. Në hapësira të mbyllura, numri i vizitorëve të pranishëm në të njëjtën kohe nuk duhet të kalojë 1 person për 20 metër katror. Në mjedise të jashtme nuk ka specifikime për numrin e lejuar të personave për 20 metër katror. <b>Hyrja është e mundur vetëm duke paraqitur një rezultat negativ të testimit të shpejtë.</b> Ky test nuk duhet të jetë më i vjetër se 24 orë.</p>
<p><b>Bizneset e shitjes me pakicë ku shiten artikuj të jo të domosdoshëm</b></p>	<p>Bizneset e shitjes me pakicë të cilët nuk shesin artikuj të domosdoshëm (artikuj ushqimorë, artikuj të përzier, dyqanet e shitjes së luleve) janë të lejuar të ofrojnë blerje nëpërmjet takimeve, me kushtin që numri i klientëve tek hapësira komerciale të kufizohet me 1 klient për 40 metër katror. Për këtë vizitë është i detyrueshëm rezervimi paraprak i një takimi dhe një kufi kohor i qëndrimit.</p>	<p>Ndalohet veprimtaria e bizneseve jo të privilegjuara.</p>	<p>Bizneset e shitjes me pakicë të cilët nuk shesin artikuj të domosdoshëm (artikuj ushqimorë, artikuj të përzier, dyqanet e shitjes së luleve) janë të lejuar të ofrojnë blerje nëpërmjet takimeve, me kushtin që numri i klientëve tek hapësira komerciale të kufizohet me 1 klient për 40 metër katror. Për këtë vizitë është i detyrueshëm rezervimi paraprak i një takimi dhe një kufi kohor i qëndrimit.</p>

**Hyrja është e mundur vetëm duke paraqitur një rezultat negativ të testimit të shpejtë.** Ky test nuk duhet të jetë më i vjetër se 24 orë.

**Shërbimet të cilat zhvillohen në afërsi fizike**

Shërbimet e zhvilluara në afërsi fizike tek të cilat nuk mbahet dot një distancë minimale prej 1,5 metrash nga klienti, lejohen nëse respektohen kërkesat për higjienën tek rregullorja. Në rastet kur klienti nuk mban dot një maskë, për shembull tek kozmetika e fytyrës, është me detyrim një rezultat testimi negativ ditor nga klienti dhe testimi i rregullt i punonjësve.

Shërbimet e zhvilluara në afërsi fizike tek të cilat nuk mbahet dot një distancë minimale prej 1,5 metrash nga klienti, janë të ndaluara. Kjo nuk përfshin shërbimet e nevojshme mjekësore, shërbimet tek flokoret, shërbimet e kujdesit jomjekësor të këmbëve dhe shërbimet e transportit komercial të pasagjerëve

Shërbimet e zhvilluara në afërsi fizike tek të cilat nuk mbahet dot një distancë minimale prej 1,5 metrash nga klienti, lejohen nëse respektohen kërkesat për higjienën tek rregullorja. **Hyrja është e mundur vetëm duke paraqitur një rezultat negativ të testimit të shpejtë.** Testi nuk duhet të jetë më i vjetër se 24 orë.

**Rregulloret e tjera në rastin e niveleve devijuese të përhapjes së infeksionit**

Krahas Masave për Frenën e Emergjencës të cilat vlejné për të gjithë Landin, qarqe dhe qytete pa qarqe tek të cilat incidenca 7 ditore, sipas njoftimeve ditore të Qendrës së Landit për Shëndetësinë, është vazhdimisht dhe dukshmërisht mbi vlerën e 100 infeksioneve të reja për 100.000 banorë dhe mbi mesataren në nivel Landi, ose aty ky ka rrethana të veçanta kritike në lidhje me infeksionet, vazhdojnë të ekzaminojnë nëse janë të nevojshme për arsye speciale masat mbrojtëse shtesë përtej kësaj urdhërese. Ato mund ti rregullojnë këto masa në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Shëndetësisë dhe Çështjeve sociale. Qarqet dhe qytetet pa qarqe, ku incidenca 7 ditore sipas njoftimeve të Qendrës së Landit për Shëndetësinë, është vazhdimisht dhe dukshmërisht mbi vlerën e 50 infeksioneve të reja për 100,000 banorë mund të bien dakord deri në ç'masë mund të implementohen reduktimet tek masat mbrojtëse të specifikuar tek Urdhëresa. Kjo gjë duhet bërë e mundur nëpërmjet bashkëpunimit me Ministrinë e Punës, Shëndetësisë dhe Çështjeve sociale.

- Pishinat për notim mund të fillojnë mësimet e notimit për fillestarë me grupe të cilat përmbajnë jo më shumë se 5 fëmijë.
- Veprimtaria e salloneve për nxirje artificiale lejohet sërish - duke qenë se këtu nuk zhvillohet shërbim me kontakt fizik me dikë tjetër dhe sipas ligjit aktual përkatës në Hamburg - nëse përmbushen kërkesat e higjienës të Urdhëresës.

Urdhëresat përkatëse do të publikohen gjatë ditës tek [www.land.nrw](http://www.land.nrw)

***Qytetarët mund t'i shtrojnë pyetjet e tyre tek ky numër telefoni 0211 855- 5.***

***Nëse keni pyetje në lidhje me zyrën e shtypit, ju lutem kontaktoni zyrën e shtypit të Ministrisë së Punës, Shëndetësisë dhe të Çështjeve Sociale, Telefon 0211 855-3118.***

***Kjo deklaratë për shtyp është gjithashtu në dispozicion tek [www.land.nrw](http://www.land.nrw)***

**[Shënim në lidhje me mbrojtjen e të dhënave në rrjetet sociale](#)**